



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:218391  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05470494

**PAKR.nr.17/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri - Kryetar i kolegjit, Vatton Durguti dhe Beqir Kalludra - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K.E. për shkak të veprës penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesat e paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda si dhe mbrojtësi i të akuzuarit K.E. av. D.D., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.380/23 të datës 28.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 05.03.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda si dhe mbrojtësi i të akuzuarit K.E. av. D.D., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.380/23 të datës 28.12.2023, **VËRTETOHET**.

## A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.380/23 të datës 28.12.2023, të akuzuarin K.E. e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, dënim i cili do të ekzekutohet 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 2.000 (dymijë) euro, të cilin dënim - gjobë i pandehuri obligohet ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit, në pajtim me nenin 79 të KPRK-së, koha e kaluar në paraburgim nga data 15.10.2023 deri me datën 22.12.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

I njëjti dënimin e shqiptuar me gjobë mund ta paguaj, me tri 3 (tri) këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par. 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke iu llogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20 euro (njëzetë euro) dënim me gjobë.

Sendet e sekuestruara përkohësisht sipas Urdhrit përfundimtar PPRKR.nr.266/2023 të datës 08.12.2023, pronë e të akuzuarit K.E. dhe e qytetarit H.G., respektivisht të gjitha sendet e poshtëshënuara i kthehen të pandehurit dhe qytetarit H.G.:

- Një furgon (Kombi) me Targa ... ;
- Një Leje qarkullimi e automjetit me nr.CRA ... (në emër të H.G.)
- Një çelës i automjetit;
- Një Telefon Samsung (ngjyrë e zezë) Galaxy A12 me numër IME11:... dhe IME12:....;
- Një Telefon Samsung (ngjyrë e zezë) Galaxy A04e me numër IME11:... dhe IME12:....;
- 198.5 Euro, me numrat serik si më poshtë:  
1X100=100euro, me numër serik:NZ3703733625;  
3X20=60euro, me numër serik:NA2703153772, FM3230801988, UD9622561941;  
2X10=20 euro, me numër serik:ËA0755004709, ËA2014881949;  
2X5=10 euro, me numër serik:VB5414724658, NB2004152967;

- 2X2=4euro;
- 2X1=2euro;
- 1X0.50=0.50 euro;
- 6X0.20=1.20 euro;
- 4X0.10=0.40 euro;
- 1X0.05=5 cent;
- 200 Lek, me numër serik AA3971122;
- 10 Dinarë Serb me numër serik: BB3636420;
- 40 Denarë Maqedon, 4X10=40, me numër serik:A3286217, AC 727950, AN254240, AJ397968;
- 1 Dollar Amerikan me numër serik B79579928F.

Është obliguar i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, si dhe shumën prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumën prej 100 (njëqind) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar përkritazi me vendimin mbi dënim për veprën penale që i vihet në barrë dhe të njëjtit ti shqiptoj dënim me burgim më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.E. av. D.D., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj si të bazuar ankesën, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit K.E. t'ia zbus dënimin.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/I.nr./2024 të dt. 19.01.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit K.E. t'i shqiptohet një dënim më i lartë me

burg, ndërsa ne parashtresën PPA/L.nr.87/2024 të dt. 09.02.2024 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësi të akuzuarit K.E. av. D.D., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-se në të cilën ka prezantuar i akuzuari K.E. dhe mbrojtësi i tij av. D.D. ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit edhe pse ka qenë i njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK, vlerësoi pretendimet ankimore të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe pretendimet ankimore të paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit, shkresat e lëndës dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se:

### **Ankesat janë të pabazuara.**

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPK-së, e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë aspekt çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i pandehuri e ka pranuar fajësinë), kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

### Pretendimet ankimore

**Prokuroria Themelore në Prishtinë** – Departamenti për Krime të Rënda në ankesë pretendon se, me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.380/2023 të dt. 28.12.2023, i akuzuari K.E. është shpallur fajtor për veprën penale Kontrabandim me migrantë nga neni 164 par. 1 të KPRK-së, dhe gjykuar me dënim me

burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) euro, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Sipas Prokurorisë, dënimi i shqiptuar në rastin konkret nuk është adekuat me peshën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit të lartcekur, andaj me një dënim të tillë të cilin Gjykata ia ka shqiptuar të akuzuarit nuk do të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit **K.E. av. D.D.** në ankesë pretendon se, vendimi mbi sanksionin penal nuk është i drejtë, duke pasur parasysh gjendjen faktike reale në këtë çështje penale në njërën anë dhe në anën tjetër mos vlerësimin e duhur të rrethanave që ndikojnë në shqiptimin e dënimit e që në rastin konkret gjykata nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese që do të ndikonin në zbutjen e dënimit. Sipas mbrojtjes, në arsyetimin e aktgjykimit gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë fare për bazë faktin se i akuzuari për të njëjtën veprë penale para rreth një viti ka qenë i dyshuar për veprën penale Kontrabandimi me migrantë ku ka mbajtur gjashtë muaj paraburgim dhe në fund me aktgjykim të plotfuqishëm është liruar si i pafajshëm, po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale ku i njëjti menjëherë pas kryerjes së veprës në polici gjatë marrjes në pyetje e ka pranuar fajësinë dhe shprehur keqardhjen për veprën e kryer. Për më tepër mbrojtja thekson se nuk janë marrë për bazë rrethanat familjare dhe personale të kryesit, duke mos vlerësuar se i njëjti është kryefamiljar, baba i dy fëmijëve, me gjendje të dobët ekonomike me ç'rast me ekzekutimin e këtij dënimi do të pasonte një dëm i konsiderueshëm për të akuzuarin dhe familjen e tij ngase janë të varur nga puna e tij dhe do të mbesnin pa asnjë të ardhur, andaj mbi këto rrethana ka propozuar si më lartë.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se, pretendimet e paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prishtinë për një dënim më të ashpër, ndërsa nga mbrojtësi i të akuzuarit për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rrjedh se Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së ashtu që në rastin konkret ka vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin e tij lidhur me veprën penale dhe betimin se në të ardhmen nuk do të përsërit veprat penale,

ndërsa nga rrethana rënduese vlerësoi rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre, përgjegjësini dhe përgjegjshmërinë e plotë penale, të kaluarën kriminale për të pandehurin për faktin se i njëjti ishte i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm në lëndët penale P-3825/2012, P-284/2009, PKR-140/2020 andaj, të pandehurit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke i shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë ligjor të paraparë me neni 71 të KPRK-së ku përcaktohet se: *“1. Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: 1.3. në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”*, ku Gjykata e shkallës së parë ka respektuar kufijtë e zbutjes së dënimit të paraparë me nenin 72 pika 1.4 të KPRK-së për faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë dhe Gjykata ka vlerësuar se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Po ashtu, ka vlerësuar se një dënim i tillë do të ndikoj në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, në kompensimin e palës së dëmtuar për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore përkitazi me shqiptimin e një dënimi më të rëndë, janë të pabazuar për faktin se si të tilla janë pretendimet të përgjithësuara dhe nuk japin arsye për një dënim më të ashpër pasi që në ankesë nuk theksohet se cilat nga rrethanat gjykata nuk pati parasysh gjatë shqiptimit të dënimit me qëllim që gjykata të vlerësoj aktgjykimin në drejtim të pretendimeve konkrete ankimore. Në anën tjetër, pretendimet e paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit se, gjykata e shkallës së parë, nuk e ka marrë fare për bazë faktin se i akuzuari për të njëjtën vepër penale para rreth një viti ka qenë i dyshuar për veprën penale Kontrabandimi me migrantë ku ka mbajtur gjashtë muaj paraburgim dhe në fund me aktgjykim të plotfuqishëm është liruar si i pafajshëm, se nuk ka marrë parasysh sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale ku i njëjti menjëherë pas kryerjes së veprës në polici gjatë

marrjes në pyetje e ka pranuar fajësinë dhe shprehur keqardhjen për veprën e kryer, pastaj se nuk janë marrë për bazë rrethanat familjare dhe personale të kryesit, se i njëjti është kryefamiljar, baba i dy fëmijëve, me gjendje të dobët ekonomike me ç'rast me ekzekutimin e këtij dënimi do të pasonte një dëm i konsiderueshëm për të akuzuarin dhe familjen e tij ngase janë të varur nga puna e tij dhe do të mbeshin pa asnjë të ardhur, janë pretendime të pabazuara dhe si të tilla nuk argumentojnë për shqiptim të një dënimi më të butë se sa dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e ankimuar, ngase nga ato rrethanat e pretenduara, tani më gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar pra kanë qenë objekt i vlerësimit, ndërsa rrethanat e pretenduara familjare, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate nuk japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e një dënimi më të butë se sa dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, ngase si rezultat i të gjitha këtyre rrethanave lehtësuese të vlerësuara, gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë veprë penale, andaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më këtë dënim do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale. Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.17/2024, datë 05.03.2024**

**Bashkëpunëtorë Profesionale, Anëtarët e kolegjit,**

**Kryetar i kolegjit,**

**Gresë Latifi**

**Vaton Durguti**

**Zyhdi Haziri**

**Beqir Kalludra**